



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution**

---

## **Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës**

### **KËRKESË**

**drejtuar**

## **Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës**

**Në çështjen:** Shfuqizimin e Dekretit të Presidentes së Republikës së Kosovës nr. DKGJK-001-2014 të datës 31 gusht 2014 “*për konfirmimin e vazhimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës*”

**Palë përgjegjëse:** Presidentja e Republikës së Kosovës

**Prishtinë, më 26 shkurt 2015**

## JURISDIKSIONI

Me anë të kësaj parashtrëse dhe parashtrësës së bashkëngjitur, Avokati i Popullit kërkon shfuqizimin e Dekretit Nr. DKGJK-001-2014 të Presidentes së Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, si dhe pezullimin e këtij Dekreti deri në vendimin përfundimtar të kësaj gjykate. Kjo kërkesë është brenda jurisdiksionit të gjykatës: “Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute” (Kushtetuta, neni 135, par. 4), dhe është “[i] autorizuar të ngrrejë rastet . . . e përputhshmërisë së . . . dekreteve të Presidentit . . . me Kushtetutën” (po aty, neni 113, par. 2).

## ARGUMENTI

**PËR SHKAK SE GJYQTARËT KADRI KRYEZIU DHE ROBERT CAROLAN NUK KANË MARRË PJESË NË PROCEDURËN E RASTIT NR. KO155/14, AKTVENDIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE ËSHTË I PAVLEFSHËM SEPSE, PA PJESËMARRJEN E KËTYRE GJYQTARËVE, NUK KISHTE KUORUMIN E DUHUR PËR MARRJEN E VENDIMEVE DHE, PËR RRJEDHOJË, KËRKESA E AVOKATIT TË POPULLIT PËR SHFUQIZIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTES JAHJAGA, SI DHE PËR PEZULLIMIN E KËTIJ DEKRETI DERI NË VENDIMIN PËRFUNDIMTAR TË KËSAJ GJYKATE, MBETET E PAGJYKUAR NË PAJTIM ME LIGJIN**

**A. Sipas ligjit, gjykata nuk mund të nxjerrë asnjëlloj vendimi, duke përfshirë aktvendime për papranueshmëri, pa pjesëmarrjen e të paktën shtatë gjyqtarëve në procedurën e rastit.**

Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 19, par. 2, përcakton që “Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë”. Pa e përmbushur kuorumin në një rast të caktuar, Gjykata Kushtetuese nuk mund të nxjerrë asnjë vendim në këtë rast. Këtu përfshihen edhe aktvendimet për papranueshmëri. Megjithëse kolegji shqyrtues i rastit, i përbërë nga tre gjyqtarë, *fillimisht* e vlerëson çështjen e pranueshmërisë ose thënë ndryshe “*lejueshmërisë*” së një kërkesë (shih Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, neni 22, par. 6), kolegji mund të nxjerrë vetëm *propozim*-vendim për



papranueshmëri. Pastaj “kolegji ia dërgon të gjithë gjyqtarëve **propozim**-vendimin me të cilin hidhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së lejueshmërisë” (po aty, neni 22, par. 7, theks i shtuar). Shih, gjithashtu, Rregullin 35, par. 4, të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese (“[K]ryesuesi i Kolegjit shqyrtues përgatit **projektaktvendimin**, i cili përmban arsyet për papranueshmërinë e kërkesës dhe ia dërgon atë **projektaktvendim Sekretariatit**. Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell atë **projektaktvendim të gjithë gjyqtarëve për shqyrtim të mëtejme**, në pajtim me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese”, theks i shtuar). Vetëm nëse përbërja e plotë e gjykatës nuk paraqet kundërshtim, atëherë propozim-vendimi i kolegjit shqyrtues bëhet vendim i Gjykatës Kushtetuese (shih Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, neni 22, par. 8). Prandaj, edhe për një aktvendim për papranueshmëri, kuorumi duhet të përmbushet, sepse projektvendimi për papranueshmëri, i propozuar nga kolegji shqyrtues, duhet të shqyrtohet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm.

Për formimin e kuoromit, gjyqtarët që nuk marrin pjesë në vendimin e rastit nuk mund të konsiderohen të pranishëm. “Gjykata Kushtetuese vendos si trup gjykues i përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese” (Ligji për Gjykatën Kushtetuese, neni 19, par. 1, theks i shtuar). Nëse vendimet e Gjykatës merren nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm, rrjedhimisht bie që një gjyqtar që **nuk** merr pjesë në marrjen e një vendimi, nuk konsiderohet i pranishëm, prandaj, nuk mund të numërohet si pjesë e kuoromit të gjyqtarëve të pranishëm.

Ky interpretim i ligjit konfirmohet edhe nga praktika e përgjithshme e vetë Gjykatës Kushtetuese. Në çdo vendim të publikuar nga gjykata, faqja e parë identifikon në mënyrë eksplicite përbërjen e gjykatës për rastin e trajtuar (pas fjalëve “**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**, e përbërë nga:”, theks në origjinal). Sipas një hetimi të gjerë të të gjitha vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, që nga themelimi i gjykatës deri më sot, vërehet se janë 33 raste, në të cilat deklarohet se një gjyqtar nuk ka marrë pjesë në procedurën e rastit. Në të gjitha këto raste, përveç një rasti, emri i gjyqtarit që nuk ka marrë pjesë, hiqet nga lista e përbërjes së gjykatës.<sup>1</sup> Prandaj, praktika e vetë gjykatës konfirmon se, një gjyqtar që nuk merr pjesë në procedurë nuk konsiderohet i pranishëm në gjykatë dhe nuk mund të numërohet si pjesë e kuoromit të gjyqtarëve të pranishëm.

---

<sup>1</sup> Shih, p.sh., Aktvendimin për papranueshmëri, Rasti Nr. KI40/14, *Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*, KZZ. nr. 187/2013, të 8 nëntorit 2013 (Gjyqtari Kryeziu nuk merr pjesë në procedurë (shih par. 9) dhe, për rrjedhojë, emri i tij nuk paraqitet në përbërjen e Gjykatës në faqen e parë të Aktvendimit); dhe Aktvendimin për papranueshmëri, Rasti Nr. KI88/10, *Agim Paca kundër Enver Hasanit, ish Rektor në Universitetin e Prishtinës* (Kryetari Hasani nuk merr pjesë në procedurë (shih par. 8) dhe, për rrjedhojë, emri i tij nuk paraqitet në përbërjen e Gjykatës në faqen e parë të Aktvendimit). I vetmi devijim nga ky model ka qenë Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin Nr. KI51/13, *Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës*, Rev. nr. 113/2010, të 19 dhjetorit 2012 (Kryetari Hasani nuk merr pjesë në procedurë (shih par. 9) por emri i tij paraqitet në përbërjen e Gjykatës në faqen e parë të Aktvendimit). Megjithatë, përderisa ky ka qenë i vetmi devijim prej praktikës së Gjykatës nga 33 raste gjithsej, mund të cilësohet si lëshim teknik.

Në shikimin e parë, neni 19, par. 3 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese (“Gjykata Kushtetuese merr vendime me shumicën e votave të gjyqtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë”) mund të duket sikur lë të hapur mundësinë që një gjyqtar të jetë i pranishëm, por njëkohësisht të mos votojë.<sup>2</sup> Por, kjo mundësi eliminohet menjëherë në paragrafin tjetër në po të njëjtin nen: “Secili gjyqtar është i obliguar për të votuar për ose kundër vendimit” (po aty, neni 19, par. 4). Prandaj, duke lexuar paragrafet 3 dhe 4 të nenit 19 bashkërisht, Ligji për Gjykatën Kushtetuese nuk parasheh, në asnjë mënyrë, mundësinë që një gjyqtar të jetë i pranishëm, por njëkohësisht të mos votojë. Ky rezultat përforcon edhe më shumë paragrafin e parë të nenit 19, i cili, siç u vërejt më sipër, nuk lë asnjë mundësi që një gjyqtar të jetë i pranishëm pa marrë pjesë në vendimin e rastit. Për rrjedhojë, të paktën shtatë gjyqtarë duhet të marrin pjesë në procedurën e rastit, edhe në votim, në mënyrë që të ekzistojë kuorumi i duhur.

#### **B. Në Rastin KO155/14, më pak se shtatë gjyqtarë kanë marrë pjesë në procedurën e rastit**

Përbërja e gjykatës për Rastin Nr. KO155/14, sipas faqes së parë të aktvendimit, *thuhet* se përfshinte shtatë gjyqtarë:

“Enver Hasani, kryetar  
Ivan Cukalovic, zëvendeskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare”

Emri i gjyqtarit Kadri Kryeziu nuk paraqitet në listë, sepse ai nuk mori pjesë në procedurën e rastit, prandaj, nuk konsiderohej pjesë e trupit gjykues për këtë rast (shih Aktvendimin, par. 12).

---

<sup>2</sup> Letra e gjyqtarit Carolan, e datës 2 shkurt 2015, e diskutuar më poshtë, sugjeron një mundësi të tillë: “Ju lutem të informoheni që, megjithëse isha i pranishëm në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës kur Rasti KO155/14 është shqyrtuar dhe vendosur nga Gjykata, nuk kam marrë pjesë në shqyrtimin ose vendimin e Gjykatës sepse e kisha përjashtuar veten paraprakisht nga pjesëmarrja në shqyrtimin dhe vendimin e Gjykatës lidhur me atë rast”.



Mirëpo, gjyqtari Kryeziu nuk ishte i vetmi gjyqtar që nuk ka marrë pjesë në procedurën e rastit. Më 16 janar 2015, Avokati i Popullit u drejtoi një letër tre gjyqtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese (Snezhana Botusharova-Doicheva, Robert Carolan dhe Almiro Rodrigues). Në këtë letër, një ndër pyetjet që Avokati i Popullit u bëri gjyqtarëve ishte: “A keni kërkuar prej Kryetarit Hasani, me shkrim apo me gojë, përjashtimin Tuaj pjesërisht ose plotësisht, nga pjesëmarrja në procedurën e Rastit KO155/14?” Nga gjyqtarët Rodrigues dhe Botusharova-Doicheva, Avokati i Popullit ende nuk ka marrë përgjigje, madje as në letrat e përsëritura. Por, më 13 shkurt 2015, Avokati i Popullit mori përgjigje prej gjyqtarit Carolan. Në këtë përgjigje gjyqtari Carolan shkruan se: “nuk kam marrë pjesë në shqyrtimin ose vendimin e Gjykatës sepse e kisha përjashtuar veten paraprakisht nga pjesëmarrja në shqyrtimin dhe vendimin e Gjykatës lidhur me [Rastin KO155/14]”. Bashkëngjitur me këtë letër, gjyqtari Carolan ka dërguar, gjithashtu, një kopje të një komunikimi të brendshëm të Gjykatës Kushtetuese, i cili, sipas tij, konfirmon përjashtimin e tij prej procedurës së rastit.

Është ende e paqartë pse emri i gjyqtarit Carolan paraqitet në përbërjen e gjykatës në këtë rast, si dhe pse mospjesëmarrja e tij në procedurë nuk përmendet në tekstin e aktvendimit të gjykatës, ashtu siç kërkon shprehimisht Rregulli 7, par. 6 i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (“Kur gjyqtari përjashtohet nga procedura, Gjykata shënon në çdo vendim me shkrim apo në çdo aktgjykim se gjyqtari i përjashtuar nuk kishte marrë pjesë në procedurë”). Siç kemi vërejtur, këtë kërkesë e ka plotësuar gjykata sa i përket gjyqtarit Kryeziu, emri i të cilit është hequr nga përbërja e trupit gjykues për këtë rast, dhe për të cilin është përmendur shprehimisht se ai nuk ka marrë pjesë në procedurën e rastit. Të njëjtën gjë nuk e ka bërë gjykata sa i përket gjyqtarit Carolan. Për këtë çështje, Avokati i Popullit u ka kërkuar sqarim kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani dhe gjyqtarës raportuese të rastit, Arta Rama-Hajrizi. Por, deri më tani të njëjtët kanë refuzuar të përgjigjen, me gjithë detyrimin e tyre kushtetues (Shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 132, par. 3: “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”, theks i shtuar).

Sido që të jetë, kur llogaritet mospjesëmarrja e gjyqtarit Carolan në procedurë, e konfirmuar nga vetë gjyqtari Carolan, bashkë me mospjesëmarrjen e gjyqtarit Kryeziu, të konfirmuar në aktvendimin e gjykatës, mund të nxirret konkluzioni se, në trupin gjykues, të “përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm” (Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 19, par. 1), mbeteshin më pak se shtatë gjyqtarë. Prandaj, **Gjykata Kushtetuese nuk kishte kuorumin e domosdoshëm prej shtatë gjyqtarëve për të nxjerrë Aktvendimin në Rastin No. KO155/14.**

## KONKLUZIONI

Për arsyet e lartpërmendura, Avokati i Popullit konkludon se **nxjerrja e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO155/14 ka qenë në kundërshtim me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese**. Prandaj, kërkesa e Avokatit të Popullit mbetet e pagjykuar sipas ligjit. Për arsyet e parashtruara në parashtresën origjinale, Dekreti Nr. DKGJK–001–2014 i Presidentes së Republikës së Kosovës “*për konfirmimin e vazhdimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës*”, duhet shfuqizuar dhe duhet pezulluar menjëherë, deri në vendimin përfundimtar të kësaj gjykate.

Me nderime,  
  
Sami Kurteshi  
Avokat i Popullit

### Bashkëngjitur:

- Kërkesa e Avokatit të Popullit e datës 9 tetor 2014 për shfuqizimin e Dekretit Nr. DKGJK–001–2014 të Presidentes së Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, përfshirë kërkesën për masë të përkohshme.
- Kërkesa e Avokatit të Popullit për përjashtimin e Kryetarit Enver Hasani nga pjesëmarrja në procedurën e këtij rasti
- Letra e gjyqtarit Robert Carolan e datës 2 shkurt 2015, dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit me datë 13 shkurt 2015
- Dekreti Nr. DKGJK–001–2014 i Presidentes së Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga